



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:008190

Datë: 13.07.2021

Numri i dokumentit: 01991967

**PKR.nr.10/2021**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i Trupit Gjykses Kushtrim Shyti, me bashkëpunëtoresh profesionale Kristina Shtufi, në çështjen penale kundër të pandehurit O.M., për veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë- PP/L.nr.648/2020 e datës 11.01.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 17.06.2021 në prani të Prokurorit të Shtetit Hivzi Bajraktari, si dhe i pandehuri, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 13.07.2021 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri:

**O.M.**, i biri i N., dhe nënës V., e vajzerisë H., i lindur me *data e lindjes...*, në f.sh B., K.P., me vendbanim në P., rr. "...", nr.569, i martuar, babai i pesë fëmijëve, ka të kryerë shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të nenit 363 par.1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP):

### **REFUZOHET AKUZA**

Sepse:

Me datë 29.11.2020, rreth orës 14:20, në rrugën "...", në P., i pandehuri pa autorizim ka përdorur armë në atë mënyrë që gjatë një ahengu familjarë-darsëm, në shenjë gëzimi ka shtënë me armë disa herë në ajër, ku në vendin e ngjarjes nga ana e pjesëtarëve të policisë, janë gjetur dhe sekuestruar 3 gëzhoja të kalibrit 7.65mm.

- Me këtë i pandehuri kishte për të kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale për këtë pjesë të aktgjykimit, bien në barrë e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar është tërhequr nga ndjekja penale.

## II

**I pandehuri: O.M.,**

### **SHPALLET FAJTOR**

SEPSE:

Nga koha e pacaktuar e deri me datë 29.11.2020 rreth orës 14:20, ka mbajtur në pronësi kontroll ose në posedim armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, armën e zjarrit të tipit Broving me numër serik BB 91326, e kalibrit 7.65 mm e cila është sekuestruar nga policia.

- Me këtë ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së,

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22,38, 39, 40, 43, 69, dhe nenit 366 par.1 të KPRK-ës, e lidhur me nenet 365 dhe 366 të KPP-së të pandehurin:

### **E GJYKON**

- I. Dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro), të cilën dënim-gjobë obligohet ta paguaj në tri këste, 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan këtë gjobë, atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke ju llogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20€ (njëzet euro) dënim me gjobë.
- II. Obligohet i pandehuri të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 euro, si dhe shumën prej 50 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumë prej 80 (shtatëdhjetë) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.
- IV. Marrja e sendeve. Gjykata, në mbështetje të nenit 282 par.1 e 2 të KPP-së, si dhe nenit 366 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndaj të pandehurit nxjerrë këtë: URDHËR - URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve si në vijim: armën e zjarrit të tipit Broving me numër serik BB 91326, e kalibrit 7.65 mm. Pas

plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, spreji, duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

V. Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.648/2020 e datës 11.01.2021, ndaj të pandehurit O.M., për veprat penale. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

### I.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 17.06.2021, në të cilën ka prezantuar Prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari, i pandehuri O.M.

Para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit bënë precizimin e aktakuzës nga se për veprën penale në pikën një ku është përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm neni 367 par.1 , për shkak se arma nuk është përdorur në mënyrë kërcënuese dhe frikësuese apo edhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshme lidhur me armët , por është përdorur në shenjë gëzimi në një aheng familjar ku edhe sipas shkresave të lëndës nuk ka paraqitur rrezik për personat e tjerë e që këto elemente të kësaj vepre penale sipas dispozitivit të parë nuk qëndrojnë por inkorporohen në veprën penale të pikës dy të aktakuzës Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së andaj heq dorë nga pika e parë e aktakuzës dhe qëndroj ndaj pikës së dytë të aktakuzës, po ashtu bëje përmirësimin e dispozitivit të dytë të aktakuzës ashtu që tani e tutje duhet të jete “ nga koha e pa caktuar e deri me dt 29.11.2020 rrethe ore 14 :20 ka mbajtur në pronësi kontroll ose në posedim armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla armën e zjarrit të tipit Broving me numër serik BB 91326 , e kalibrit 7.65 mm e cila është sekuestruar nga policia” me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së .

Në prani të këtyre rrethanave, duke e patur parasysh se me tërheqjen e prokurorit , më nuk kemi objekt shqyrtimi në këtë çështje penale për veprën e lartëcekur, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në përputhje me nenin 363 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale për këtë pjesë të aktgjykimit, gjykata vendosi në përputhje me nenin 454 par.1 të KPRK-së

### II.

I pandehuri, në shqyrtimin fillestar me vullnet të plotë dhe të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr.648/2020 e datës 11.01.2021, duke

shtuar se ndihem i penduar që nuk e kam dorëzuar armën me herët , kushtet ekonomike i kam te dobëta pasi e kam edhe gruan e sëmur me kancer, kërkoj nga gjykata një dënim me te butë.

Prokurori i Shtetit dha mendimin e tij lidhur me deklarin e fajësisë së akuzuarës , dhe shtoi se pajtohem me pranimin e fajësisë pas qe pranimi fajësisë është konform neni 248 par.1 te KPPRK si dhe ne përputhje me provat te cilat gjenden ne shkresat e lëndës, andaj i propozoj gjykatës qe ta aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, njëherit i propozoj gjykatës qe me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ta merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë së të pandehurit.

Andaj pas deklarinimit i pandehuri se ndjehet fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitivin e nenit 248 par.1 të KPPRK-së, lidhur me pranimin e fajësisë.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestar dhe nga pranimi i fajësisë u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu edhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: deklarata e të pandehurit, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 29.11.2020 si dhe shkresat e tjera të lëndës , gjykata gjeti se në veprimet i pandehuri formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPPRK-së, për të cilën akuzohet i pandehuri. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

*-Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:*

Me rastin e matjes së dënimit gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 të KPPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin lidhur me veprën e kryer, premtimin para gjykatës se në të ardhmen nuk do të ndodhë më kurrë një gjë e tillë ndërsa rrethana rënduese gjeti rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë, po ashtu se kjo armë e zjarrit është e ndaluar për popullsinë civile sipas Ligjit mbi armët andaj të pandehurit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke mos gjetur rrethana tjera rënduese.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj veprë penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në

parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, në kompensimin e palës së dëmtuar për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

*- Konfiskimi:*

Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2 të KPP-së, dhe nenit 366 par.3 KPRK-së, ndaj të pandehurit ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armën e zjarrit të tipit Broving me numër serik BB 91326, e kalibrit 7.65 mm. Gjykata rikujton se i pandehuri se nuk kishte leje e as autorizim për posedimin e armës. Në anën tjetër sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike nga këto arsye gjykata ka vendosur t'i konfiskoj përherë dhe të njëjtat ka urdhëruar që të shkatërrohen. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armës sipas nenit 366 par.3 KPRK-ës, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm.

*-Shpenzimet e procedurës*

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet për ekspertë dhe të paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.10/2021 Datë 13.07.2021**

**Bashkëpunëtoreshë profesionale  
Kristina Shtufi**

**Kryetari i trupit gjykues -Gjyqtari  
Kushtrim Shyti**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.